



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës/Izvršno Telo Inspektorata Rada  
Exekutive Body of Labour Inspectorate

Ne baze të nenit 5.5 të Ligjit për Inspektoratin e punës nr. 2002/9, nenit 32, par.1, Nenit 37, par. 4 e 6, dhe nenit 38 par. 2, e 3, të Ligjit të punës nr. 03/I-212, TEIP Prishtinë, Inspeksioni i punës në Podujevë, më 27. 05. 2011 v. mirë këto:

#### AKTVENDIM

- I. URDHEROHET Punedhësit "FAN" shpk. Podujevë, që të nxirr Vendimet për shfrytëzimin e pushimeve vjetore për punëtor të cilët nuk e kanë shfrytëzuar gjatë viti 2010.
- II. Pushimet vjetore për 2010 duhet të kryhen perfundimisht më 30. 06. 2011 v.
- III. Në rast se Punedhësi nuk nxirr vendime për lejimin e pushimeve vjetore, të vitit 2010, atëherë OBLIGOHET që të bëjë kompensimin me të holla, që caktohet vërsisht nga kohe zgjatja e pushimit vjetor të pa shfrytëzuar për atë muaj që punëtori kompensohet.
- IV. Për zbatimin e këtij aktvendimi përgjegjës është Punedhësi Agim Dëshishku.
- V. Ankesa nuk e ndal zbatimin e këtij aktvendimi.

#### A r e s y e t i m

TEIP Prishtinë Inspeksioni i punës në Podujevë, bëri kontrollin inspektues të punës pranë SA. "FAN" shpk. Podujevë, në kërkesë të Kryetarit të sindikates dhe Kryetarit të Keshillit grevist, ku u kerkua që të mundësohet dhe të ipen pushimet vjetore punëtorëve, të cilët nuk e kanë shfrytëzuar pushimin vjetor për vitin 2010 v. për shkak të ndryshme.

Gjatë kontrollit inspektues të jashtëzakonshme u konstatua në mes tjerash një numër mbi 15, punëtor, që regjistri i punëtorëve do të bashkëngjitet këtij aktvendimi, nuk e kanë shfrytëzuar pushimin vjetor për vitin 2010, për shkak të brendshme organizative.

Nga kontrolli kryes Inspeksioni i punës erdhi në konstatim se të gjithë punëtorëve, që nuk e kanë shfrytëzuar pushimin vjetor 2010, të leshohen vendimet për pushim vjetor dhe atë gjatë muajit qershor 2011. ose të bëhet kompensimi me të holla, konform dispozitave të lart cekura.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**UDHEZIM JURIDIK:** Kunder këtij aktvendimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8. ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, TEIP Prishtinë, përmes Inspeksionit të punës Podujevë.

Ti dërgohet:

1. "FAN" Podujevë,
2. në dosje të lëndës,

Nr. 213, dt. 27. 05. 2011 v.

INSPEKTORET E PUNES

Xhevat Latifi,

Beqir Hazir